

Agrigose shpk

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Së bashku me Raportin e Audituesit të pavarur

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	8 – 26

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Ortakëve të Shoqërisë “Agrigose” Sh.p.k.

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “Agrigose” Sh.p.k. (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2020, dhe pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne, gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Kreston Albania Sh.p.k.

Rruga Muhamet Gjollesha, shk. B, K. 6, Ap. B-6

Pranë Qendrës Tregtare Ring Tirane Shqipëri, 1001

Numri I Identifikimit të Personit të Tatueshëm L42007012I

Nuriona Bërdica Sokoli

Partner Angazhimi

Tiranë më, 18 qershor 2021

Agrigose shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020**

	Shenime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive afatgjate			
Aktive afatgjata materiale	6	149,757,268	160,695,876
Aktivitet biologjike	7	16,334,725	9,888,669
Totali i aktiveve afatgjata		166,091,993	170,584,545
Aktive afatshkurtra			
Shpenzime te shtyra	8	712,500	162,500
Inventare dhe aktive biologjike afatshkurter	9	61,304,154	71,564,113
Llogari të arketueshme tregtare dhe llogari të tjera të arketueshme	10	50,896,759	54,372,384
Tatim fitimi i parapaguar	11	180,800	180,800
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12	124,141	3,461,255
Totali i aktiveve afatshkurtra		113,218,354	129,741,052
TOTALI I AKTIVEVE		279,310,347	300,325,597
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nenshkruar		389,110,777	389,110,777
Fitime/(humbje) te mbartura		(298,800,384)	(301,068,104)
Fitimi i ushtrimit		4,979,703	2,267,720
Totali i kapitalit	13	95,290,096	90,310,393
Detyrime afatgjata			
Huamarrje	14	39,169,138	49,357,441
Te ardhura te shtyra	15	15,161,539	29,679,961
Totali i detyrimeve afatgjata		54,330,677	79,037,402
Detyrime afatshkurtra			
Huamarrje	14	23,047,839	18,866,232
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	16	18,777,672	11,433,721
Detyrime financiare te tjera	17	87,396,915	100,354,570
Detyrime te tjera	18	467,148	323,279
Totali i detyrimeve afatshkurtra		129,689,574	130,977,802
Detyrime totale		184,020,251	210,015,204
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		279,310,347	300,325,597

Shënimet shpjeguese të faqeve 8 - 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Agrigose shpk*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Te ardhurat nga aktiviteti shfrytëzimit	19	75,380,384	72,099,297
Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	9,032,521	3,535,257
Total te ardhura		84,412,905	75,634,554
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	21	(45,665,366)	(46,425,582)
Shpenzime amortizimi dhe zhvleresimi	6	(14,103,198)	(13,390,267)
Shpenzime personeli	22	(10,193,269)	(8,583,688)
Shpenzime te tjera	23	(4,423,250)	(4,809,510)
Total shpenzime		(74,385,083)	(73,209,047)
Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto	24	(5,048,119)	(157,787)
Fitimi/(humbja) para tatimit		4,979,703	2,267,720
Tatimi mbi fitimin	25		-
Fitimi/(Humbja) e vitit		4,979,703	2,267,720
Te ardhura te tjera gjithepershiresë			
Totali i te ardhurave te tjera gjithepershiresë		-	-
Totali i te ardhurave gjithepershiresë		4,979,703	2,267,720

Shënimet shpjeguese të faqeve 8 - 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Agrigose shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet/ (humbjet) e paspërndara	Fitimi I ushtrimit	Totali
Pozicioni financiar I rideklaruar ne fillim	389,110,777	(301,068,104)	-	88,042,673
Fitim/(humbja) e vitit			2,267,720	2,267,720
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse				-
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2019	389,110,777	(301,068,104)	2,267,720	90,310,393
Fitim/(humbja) e periudhes			4,979,703	4,979,703
Transferime ne fitime te mbartura/ humbje te akumuluar		2,267,720	(2,267,720)	-
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2020	389,110,777	(298,800,384)	4,979,703	95,290,096

Shënimet shpjeguese të faqeve 8 - 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Administratori më _____ dhe janë firmosur si më poshtë :

Z. Albi Avdiu
Administrator

Znj. Fidarie Qela
Menaxhere e financës

Agrigose shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	4,979,713	2,267,720
<i>Rregullime per te ardhura dhe shpenzime jo-monetare:</i>		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	14,103,198	13,390,267
<i>Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit</i>		
Renie/(Rritje) ne të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	3,475,624	33,206,834
Renie/(Rritje) ne inventare	10,259,959	4,576,515
Renie/(Rritje) ne detyrimet e pagueshme	7,343,955	(20,076,286)
Rritje/(Renie) ne detyrime për punonjësit	127,717	116,133
Rritje/(Renie) ne detyrime te tjera	(12,941,503)	14,791,488
Rritje/(Renie) ne nga te shtyra	(15,068,422)	970,000
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	12,280,241	49,242,671
Tatim fitimi i paguar gjate periudhes	-	-
	-	-
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(6,202,907)	(25,405,291)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(3,407,750)	(3,043,186)
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	(9,610,657)	(28,448,477)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(6,006,698)	(20,046,316)
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	(6,006,698)	(20,046,316)
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	3,461,255	2,713,377
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	124,141	3,461,255

11

Shënimet shpjeguese të faqeve 8 - 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i Përgjithshëm

Agrigose Sh.p.k (me poshte referuar si Shoqeria), u themelua ne vitin 1993 si nje ndermarrje bujqesore me NUIS J72902823F.

Shoqeria ka si objekt te aktivitetit ekonomik kultivimin dhe prodhimin e bimeve te fushes me teknologji moderne dhe tregtine me shumice e pakice te produkteve bujqesore.

Bazuar ne vendimin e asamblese se ortakeve te dates 23.06.2014, kuotat e Valeria Italia Srl u shiten tek American Capital Sh.p.k. qe kontrollon 91.76% te kuotave te Shoqerise, ndersa 8.24% e kuotave zoterohen nga ortaku “Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes”.

Administrator i vetem i Shoqerise eshte Z. Albi Avdiu.

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne adresen kryesore Tre Urat- Grabian km 2. Lushnje- Fier

Shoqeria më 31 dhjetor 2020 ka patur 14 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të pa parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përkrahur më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatit e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2020, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve – efektive për periudhat pas 1 janar 2021
- Amendimet e SNK 1 dhe SNK 8 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020
- Amendimet e SNRF 3 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020
- Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar – efektiv për periudhat pas 1 janar 2020

3.2 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Bordi Nderkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standard dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standard dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2020:

- Amendimi i IFRS 16 – efektiv pas 1 qershor 2021
- IFRS 7 dhe IFRS 4 “Kontratat e Sigurimit” – efektive pas 1 janar 2021
- Amendimi SNK 1 “Prezantimi i pasqyrave financiare” – efektive në ose pas 1 janar 2022

3. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e këmbimeve në monedhë të huaj regjistrohen me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në ditën e transaksionit. Aktivet dhe pasivet monetare të emetuara në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhë funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në datën e bilancit. Zërat jo monetarë të mbajtur me vlerë të drejtë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike nuk konvertohen.

Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 ishin si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/LEK	123.7	121.77
USD/LEK	100.84	108.64

4.2 Instrumenta financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë e dispozitave kontraktuale mbi instrumentin.

Instrumentet financiare - njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohe me së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktivitetet financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - kategoritë e matjes. Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA (sipas paragrafit më lart). Klasifikimi dhe matja e mëpasme e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) Modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve dhe (ii) karakteristikat e fluksit monetar të aktivitetit.

Aktivitetet financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - modeli i biznesit. Modeli i biznesit reflekton mënyrën sesi Shoqëria menaxhon aktivet për të gjeneruar fluks monetar – nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale (“mbajtja për mbledhje e flukseve monetare”) ose (ii) mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe të flukseve monetare që gjenerohen nga shitja e aktiveve (“mbajtja për mbledhje e flukseve monetare dhe shitje”) ose, nëse objektivi (i) dhe (ii) është jo i aplikueshëm, aktivet financiare klasifikohen si pjesë e modelit të biznesit “të tjera” dhe maten në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet financiare individuale (në nivel individual) bazuar në të gjithë evidencën përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin individual në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen menaxherët. Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Shoqëria në përcaktimin e modeleve të biznesit për aktivet e saj financiare.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Aktivet financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare. Kur modeli i biznesit ka si objekt mbajtjen e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ose mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm shumën për riskun e kredisë, vlerën kohore të parasë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit.

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj riskut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, aktivi financiar klasifikohet dhe matet me VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Shoqëria në kryerjen e testit VPPI për aktivet e saj financiare.

Aktivet financiare - fshirja. Aktivet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka kryer çdo përpjekje për rimarrjen dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rimarrjen. Fshirja përfaqëson një rast të çregjistrimit. Treguesit që nuk ka pritshmëri të arsyeshme të rimarrjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mosshlyerjes, paaftësi paguese dhe falimentim. Shoqëria mund të fshijë aktivet financiare që janë subjekt i zbatimit me forcë të marrëveshjes kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që janë të arkëtueshme sipas termave kontraktuale, megjithatë, nuk ka pritshmëri të arsyeshme për marrjen e tyre.

Aktivet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet shlyhen ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet përfundojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve.

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare - kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura në KA, përveç (i) detyrimeve financiare të matura me VDNFH: ky klasifikim aplikohet për derivativet, detyrimet financiare të mbajtura për shitje (p.sh. pozicionet afatshkurtra me letra me vlerë), shuma e kushtëzuar e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare - çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato likuidohen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

Netimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për netimin e shumave të njohura dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë netimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagëse dhe (iii) në rast të paaftësisë paguese ose falimentimit.

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, që përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera dhe huatë afatshkurtra. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Shoqërisë maten me koston e amortizuar.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion midis palëve të vullnetshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe evidentohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Shoqërisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma me të cilën instrumenti financiar është njohur në njohjen fillestare minus çdo pagesë principali, plus interesin e përlogaritur dhe për aktivet financiare, minus çdo zbritje për humbje të pritshme të kredisë.

4.3 Parapagimet

Parapagimet maten me kosto minus provizionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aktiv që do të klasifikohet si afatgjatë pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël neto të aktivit sapo Shoqëria merr kontrollin e aktivitetit dhe pret nga ky aktiv përfitime ekonomike të ardhshme. Parapagimet e tjera njihen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një tregues se aktivet, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të merren, vlera e mbartur e parapagimit zhvlerësohet dhe një humbje nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

4.4 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjelle inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vleresuara në bilanc me vlerën e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim si vlerën me të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.3 Aktive afatgjata materiale

- *Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktivitetit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivitetit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**4.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

- *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

- *Amortizimi*

Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe paisje	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Ndertesat	Vlera e mbetur	5%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5 Te ardhurat

Te ardhurat njihen atëhere kur është e mundur që njesia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Te ardhurat maten me vlera të drejta të arketuar ose të arketueshme që merr parasysh Shumen e cfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjehershme dhe zbritjet për sasi të blere.

4.6 Fondet për pensione

